

Qendra Shqiptare per Tregtine Nderkombetare (ACIT), me mbështetjen financiare të USAID dhe Fondacionit për Shoqëri të Hapur (SOROS) në Tiranë, po realizon projektin me temë:

“Lehtësimi proceseve doganore dhe marrëdhënieve të biznesit me administratën doganore”

Situata/Motivimi

Krijimi i një mjedisi lehtësues për zhvillimin e biznesit dhe aktiviteve të tregtisë përbëjnë orientimin themelor të politikave të zhvillimit të sektorit privat, rritjes ekonomike dhe reduktimit të varfërisë. Numri i institucioneve që përfshihen në procesin e hartimit të politikave dhe zbatimit të tyre është i madh: që nga ministrinë dhe grupet ndërminstrore, agjensi qeveritare apo gjysëm qeveritare e deri tek shoqata apo grupe të interesuara të biznesit dhe të organizuara në forume të ndryshme. Në gjithë morinë e aktorëve dhe institucioneve që veprojnë në këtë fushë, padyshim që organet e administratës doganore përbëjnë institucionin kryesor në procesin e zbatimit të politikave tregtare. Duke qenë pika e parë e kontaktit në trafikun e lëvizjes së mallrave midis vendeve, politikave dhe praktikave administrative të zbatuara nga këto institucione janë me efekte të rëndësishme në eficiencën e transaksioneve tregtare. Efektet e drejtpërdrejta të këtyre praktikave pasqyrohen në kostot e transaksioneve dhe për rrjedhojë, ato lehtësojnë ose bëhen barriera për lëvizjen e mallrave midis vendeve.

Reformat e deritanishme të kryera, qoftë në nivelin e politikave të zhvillimit të biznesit dhe lehtësimit të tregtisë, apo dhe në nivelin operacional të zhvillimit të institucionit të administratës doganore, kanë krijuar padyshim një progres të rëndësishëm. Legjislacioni doganor është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme; praktikave doganore gjithashtu kanë progresuar pozitivisht në drejtim të lehtësimit të aktivitetit tregtar (të mbështetur dhe me projekte të rëndësishme të shumë donatorëve, ku më i rëndësishmi është projekti për Lehtësimin e Transportit dhe Tregtisë në Europën Juglindore, financuar nga disa donatorë ndërkombëtarë dhe qeveri perëndimore); vetë institucioni është zhvilluar përmes programeve të rëndësishme mbështetëse nga organizmat ndërkombëtar apo projekte të financuara nga institucionet e Bashkimit European (si CAM-Albania, etj).

Megjithë stokun e progresit të realizuar dhe të evidentuar tashmë, një numër raportesh organizatash të pavarura studimore apo dhe raporte të organizmave ndërkombëtare, kanë theksuar aspekte të dobësive të punës në këre administratë. Një ndër konstatimet më të rëndësishme të realizuar së fundmi ishte raporti vlerësues i Komisionit European për vitin 2003. Ndër të tjera **raporti thekson dobësitë dhe mangësitë e vërejtura në procedurat dhe rregullat e tranzitimit, të vlerësimit doganor; regjimit të magazinave doganore; të vlerësimit të riskut dhe të auditimit** (brendshëm dhe jashtëm). Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare (aty ku ekzistojnë) dhe të BE-së janë një ndër kushtet e vendosura në raport dhe që pritet të finalizohen në një Vendim të Komisionit European për Shqipërinë.

Qëllimi projektit

Ky projekt duke u fokusuar ne vlerësimin e procedurave doganore, të përputhshmërisë së këtyre procedurave, me standartet nderkombëtare dhe angazhimet kombëtare në kuader të liberalizimit të tregtisë synon të japë një kontribut, në krijimit e një ambienti më të përshtatshëm për zhvillimin e sipërmarrjes private dhe tregtisë në vend. Studimet e kryera në funksion të përmbushjes së këtij qëllimi dhe aktivitetet që do të organizohen për këtë qëllim me grupet e ndryshme të interesit, do të sjellin një veshtrim mbi problematikën e sistemit dhe mendime nga grupet e interesit për përmirësime, që për rrjedhojë, do të lehtësojnë kostot e transaksioneve tregtare, dhe do të behen pjesë e përpjekjeve për uljen e praktika korruptive në këtë institucion.

Objektivat e projektit

Ky projekt synon të ndërmarrë një studim tërësor të politikave dhe praktikave të administratës doganore në drejtimet e përmendura në raportin e Komisionit European dhe të sugjerojë përmirësimet në funksion të lehtësimit të tregtisë dhe aktiviteteve tranzite të mallrave nëpërmjet territorit doganor të vendit.

Pesë dimensionet e kërkimit (rregullat e tranzitimit, të vlerësimit doganor; regjimit të magazinave doganore; të vlerësimit të riskut dhe të auditimit (brendshëm dhe jashtëm) do të analizojnë legjislacionin (bazën rregullatore) dhe praktikën e administratës doganore shqiptare në raport me: (a) praktikat më të mira ndërkombëtare dhe/ose standartet ndërkombëtare (kryesisht referuar Protokollit të Kyotos: Marrëveshja Doganore, pjesë e rregullave në tregtisë në kuadër të OBT-së); dhe (b) kërkesat e legjislacionit dhe praktikës së Bashkimit European. Në praktikën e punës së administratës doganore, do të testohet gjithashtu dhe problemet që mund të jenë krijuar në procesin e zbatimit të Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë me vendet e rajonit.

Raporti përfundimtar i kërkimit do të ofrojë sugjerime për përmirësime, si në legjislacion dhe bazën rregullatore, ashtu dhe në praktikën tonë doganore të aplikuar. Në dijen tonë më të mirë, nuk dimë të ekzistojë një studim i tillë siç paraqitet në këtë projekt propozim dhe as të ketë ndonjë projekt tjetër analog të propozuar.

Duke sjellë një vështrim të thelluar të eksperiencave më të mira dhe praktikave europiane në këto drejtime, projekti synon të kontribuojë në:

- Përmirësimin e klimës së biznesit dhe të investimeve në vend;
- Përmirësimin e marrëdhënieve të administratës doganore me sektorin privat;
- Plotësimin e legjislacionit dhe bazës rregullatore të praktikave doganore dhe reduktuar kështu hapësirat për interpretime subjektive dhe praktika korruptive.

Metodologjia e studimit

Metodologjia e studimit do të shtrihet në tre aspekte kryesore që do të jenë

a) Studim krahasimor i legjislacionit dhe praktikave doganore shqiptare me ato Europiane dhe rajonale, studim që do të synojë të evidentojë problemet dhe eksperiencat pozitive të zgjidhjes së tyre. Ky hap do të përfshijë aktivitetet e mëposhtme:

- Grumbullimi i literaturës (bazën ligjore dhe rregullative dhe praktikës sonë administrative; standardeve ndërkombëtare në këtë fushë dhe legjislacionit europian); (Periudha e realizimit: Qershor, 2004)
- Konsultimet me grupet e interesit për problemet e shfaqura përgjatë secilit nga dimensionet e kërkimit që propozohet; (Periudha e realizimit: Qershor, 2004)

Si hap i dytë i studimit do të jetë eksplorimi në terren i problematikës me synim vlerësimin se në çfarë shkalle manifestohen këto problematika dhe se çfarë kostoje ato kanë manifestuar si për administratën doganore, në aspektin e menaxhimit dhe zgjidhjes, po sidomos e rëndësishme do të jetë vlerësimi i kostove që ka përballuar iniciativa private e biznesit dhe tregëtisë.

- Vizita në pikat doganore (3 vitiza) ku do të testohen në terren praktikatat ligjore dhe aplikimet konkrete si dhe do të diskutohet me autoritetet në terren mbi rekomandimet që priten të sugjerohen nga studimi dhe realizimi praktik i tyre; (Periudha e realizimit: Korrik, 2004)
- Përgatitja e një pyetësori që do të përmbledhë problematiken e hasur qoftë nga studimi i legjislacionit dhe praktikave ashtu dhe nga diskutimet me grupet e interesit në pyetje vlerësuese për të bërë të mundur mbledhjen e informacionit mbi perceptimin praktik të nivelit të problematikave (Korrik, 2004). Pyetësoret do të targetojnë një sample të rastësishme në grupet e interesit, por duke i dhënë përparësi në peshe komunitetit të biznesit.
- Përgatitja e draftit të parë të studimit; (Periudha e realizimit: Korrik, 2004)

Faza përfundimtare do të përfshijë një “public outreach” të draftit, të parë të studimit, nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- Organizimi i një seminari kombëtar, me pjesëmarrjen e biznesit dhe administratës shtetërore (kryesisht asaj doganore) ku do të prezantohen gjetjet e raportit dhe sugjerimet e tij në secilin nga dimensionet e propozuara. (Periudha e realizimit: Shtator, 2004)
- Mendimet e tërhequra dhe vërejtjet përfundimtare të këtij aktiviteti do të ushqejnë realizimin dhe paraqitjen para autoriteteve zyrtare të raportit përfundimtar. Raporti dhe rekomandimet e propozuara do t’i dërgohen komunitetit të biznesit dhe Këshillit Konsultativ të Biznesit për t’u përdorur në procesin e hartimit/axhustimit të politikave (apo pranë grupeve të punës së ngritura për zbatimin e detyrave në kuadër të studimit të FIAS). (Periudha e realizimit: Shtator, 2004)

- Përgatitja e raportit përfundimtar për donatorët e projektit, duke vlerësuar gjithë procesin, produktet e realizuara dhe një vlerësim rigoroz të impakteve të pritshme.

Rezultatet e pritshme

Lehtësimi i tregtisë dhe investimeve; reduktimi hapsirave për praktika diskriminuese doganore dhe për interpretime subjektive duke ndikuar kështu në ngushtimin e hapësirave për praktika korruptive në marrëdhëniet e kësaj administrate me sektorin privat.

Përfituesit

Grupi kryesor përfitues nga aktivitetet dhe produktet e këtij projekti janë *komuniteti i biznesit të vendit dhe të huaj*. Reduktimi i barrierave administrative në marrëdhëniet e këtij grupi me administratën doganore pritet të sjellë lehtësim të aktivitetet tregtar, reduktim të hapsirave për praktika subjektive dhe abuzive, pra dhe të korrupsionit. Përfitues final janë konsumatorët, nëpërmjet çmimeve më të ulëta dhe buxheti shtetit, në saj të rritjes së niveleve të arkëtimeve doganore për shkak të reduktimit të hapsirave për evazion.